



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE**

SHPALLJE PËR POZICIONIN DREJTOR DREJTORIE

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

**Drejtore i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë
Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve**

Afati për dorëzimin e dokumenteve 07/03/2025 pranë Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

Përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës është:

- a) Përcaktimi i objektivave dhe detyrave të sektorëve përbërës, për monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe koordinimin mes tyre;
- b) Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, si dhe mirëmenaxhimi financiar;
- c) Planifikimi dhe mirëadministrimi i burimeve njerëzore;
- d) Menaxhimi i aseteve të Ministrisë, të logjistikës dhe shërbimeve të tjera;
- e) Sigurimi i asistencës ligjore për të gjithë veprimtarinë organizative dhe teknike të Agjencisë.
- f) Menaxhimi të gjitha ankesat administrative dhe gjyqësore në bashkëpunim me drejtoritë e tjera teknike.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor” ose të barasvlefshëm me të, në shkenca Ekonomike/Juridike;
- d) Të kenë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune;
- e) Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- f) Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- g) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;
- h) Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
- i) Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- j) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- k) Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- l) Të kenë aftësi të mira menaxheriale dhe të procedurave administrative;
- m) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- n) Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- o) Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- g- Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - gj- Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në AKEM brenda datës 07/03/2025.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të AKEM www.akem.gov.al, tek kategoria “publikime”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Njohuri për Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimi e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
- c- Platformën e tyre për të siguruar një sistem të shëndoshë kontrolli të brendshëm që të mbështesë realizimin e synimeve dhe objektivave të Agjencisë.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në AKEM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 07/03/ 2025 në protokollin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 12.03.2025, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.